

Këshilla për ju si familje

- > Flisni me fëmijën tuaj shumë në gjuhën në të cilën e ndjeni vetën më së miri dhe e zotëroni më së miri.
- > Lexoni me të shumë.
- > Gjeni mundësitë që fëmijë juaj të ndërtojë marrëdhënie dhe besueshmëri me njerëzit që e flasin këtë gjuhë të re.
- > Shkoni në vende me lojra si dhe vende të cilat vizitohen nga fëmijë e të ritur të cilët flasin gjuhën e re.
- > Përpiquni të gjeni mundësi që fëmijë juaj të vizitojë grupe të lojrave, sporti, muzikë, teater dhe biblioteka ku do të mund ta përfjoshin gjuhën e re në mënyra të llojllojshme.
- > Përpiquni të gjeni dhe kultivoni kontakte me njerëzit që e flasin këtë gjuhë.
- > Gëzohuni së bashku me fëmijën tuaj për fjalët e reja që i flet në gjuhën e re dhe tregoni se keni interesim që ti mësoni edhe ju ato.
- > Bëhuni shembull dhe provoni edhe ju ta flisni gjuhën e re.

FËMIU IM DHE GJUHA/GJUHËT E TIJ

Edukimi gjuhësorë në familje

2. Si e mëson fëmijë im me sukses një gjuhë të re?

Fletushka të përkthyer në gjuhë tjera të kësaj serie si dhe burimet i gjeni këtu:



Linku i rekomanduar:



Kindergarten

Botuesi:
Deutsche Bildungsdirektion
Landesdirektion deutschsprachiger Kindergarten

*Me përkrahje të Referatit të Qendrës për Migracion dhe Gjuhë si dhe shkencëtarës gjuhësore
Dr. Christiane Hofbauer*

Amba-Alagi-Straße 10
39100 Bozen
T 0471 41 76 50
ld.kindergarten@provinz.bz.it

Si e mëson fëmijë im me sukses një gjuhë të re?

2

Familja dhe rrethi i fëmijës janë vendimtar

FËMIU IM DHE GJUHA/GJUHËT E TIJ

Edukimi gjuhësorë në familje



ALBANISCH
SHQIP



Flisni me fëmion në gjuhën tuaj

Secili prind qysh prej lindjes së fëmijut i flet në gjuhën që e ndjen vetën mirë dhe që e din dhe e zotëron më së mirë.

Pse?

Të folurit e gjuhës në të cilën ju e ndjeni vetën mirë dhe të sigurt ndikon pozitivisht në mardhënjet prind-fëmijë.

Gjuha ose gjuhët e folura në familje janë të rëndësishme për identitetin e fëmijut.

Mësimi i gjuhës së parë është një bazë e mirë për mësimin e gjuhëve të tjera. Nëse fëmijë në gjuhën e tij të parë ndjen veten të fortë është ky një parakusht për mësimin e gjuhëve të tjera.

Fëmiut i lehtësohet mësimi i një gjuhe të re nëse:

- > nëse për ju mësimi i një gjuhe të re është i rëndësishëm
- > nëse si familje jeni të hapur për gjuhë të reja
- > nëse fëmijë i juaj ka interesim që të mësojë një gjuhë të re që të merret vesh me shokë e shoqe
- > nëse fëmijë edhe jashtë shkollës has në gjuhën e re në një ambient të njohur
- > nëse shumë njerëz përrreth rregullisht me fëmijë tuaj e flasin gjuhën e re
- > nëse rrethi, të gjitha mundësitë e komunikimit (si ato verbale dhe joverbale) të fëmijë tuaj i çmon dhe nuk i bën presion

Rrugëtimi arsimor i fëmijë tuaj: një vendim, i cili duhet të jetë i menduar mirë

- > Arsimimi i fëmijë zgjat me vite dhe duhet të përcillet edhe nga ju si familje.
- > Fëmijë përfiton nëse në shkollimin parashkollorë dhe në shkollë mësohet gjuha e njëjtë. Mendojeni këtë fakt para se të vendosni ta regjistroni fëmijë në parashkollor.
- > E rëndësishme është që prindërit të jenë të pajtimit për zgjedhjen e shkollës.
- > Kujdesuni që gjuha që do të flitet në atë shkollë, sa më shpejtë që të jetë e mundur të kuptohet. Përpikuni të gjeni një person që do të ju përcjell, përkrahë dhe rast nevojë të bëjë përkthyesin.

